



RAPORTI VJETOR

PLATFORMA "SHQIPËRIA QË DUAM"

2 0 1 8



www.shqiperiaqeduam.al



RAPORTI I VITIT 2018 I ZYRËS SË BASHKËQEVERISJES

Bashkëqeverisja me njerëzit e zakonshëm në vitin 2018 është konsoliduar si praktika më efikase e ndërveprimit mes qytetarëve dhe qeverisë duke dëshmuar vlerën dhe potencialin e saj të jashtëzakonshëm për Shqipërinë që Duam.

Një adresë e vetme, shqiperiaqeduam.al, në një vit shërbeu për të thirrur në interpelancë direkte ministrat, për të realizuar konkretisht nisma për komunitetin, për t'i dhënë zë çdo studenti në Paktin për Universitetin apo përgjigje pyetjes së tij dhe zgjidhje 18.276 ankesave nga 26,936 të paraqitura.

19,800 qytetarë pa dallim bindjesh e përkatësish politike, janë përdorues e kontribues aktivë të regjistruar në koalicionin bashkëqeverisës në platformën shqiperiaqeduam.al.

Me vetëm një mesazh Ju keni në dispozicion të drejtëpërdrejtë çdo ministër. Zgjidhni problematikën Tuaj, përcillni fjalën Tuaj deri në qeveri, e njëkohësisht ndikoni që qeverisja të bëjë më shumë e më mirë, për Shqipërinë që duam me shtet-punë-mirëqenie.



INSTITUCIONI

TOTAL

22706

TË ZGJIDHURA

16213

ANKESA

ANKESA

● KRYEMINISTRIA

399

367

● MINISTRIA E DREJTËSISË

9332

4954

● MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

2205

1999

● MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

2347

2172

● MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË

3575

2909

● MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

1844

1336

● MINISTRIA E BRENDSHME

1291

1071

● MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

452

313

● MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

366

346

● MINISTRIA E MBROJTJES

297

244

● MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

168

148

● MINISTRIA E KULTURËS

90

68

● MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

40

28

● MINISTRI I SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

300

258



BASHKIA

TOTAL

4230

ANKESA

TË ZGJIDHURA

2063

ANKESA

QARKU
TIRANË

● TIRANË

1264

854

● KAVAJË

82

2

● KAMËZ

74

12

● VORË

22

13

● RROGOZHINË

15

7

● VLORE

355

275

QARKU
VLORE

● HIMARË

67

45

● SARANDË

58

46

● DELVINË

21

13

● SELENICË

37

6

● FINIQ

9

7

● KONISPOL

8

2



TË ZGJIDHURA	TOTAL	B A S H K I A	
2063	4230		
ANKESA	ANKESA		
43	116	KORÇË	Q A R K U K O R Ç Ë
26	90	POGRADEÇ	
21	55	MALIQ	
6	21	DEVOLL	
5	20	KOLONJË	
33	87	BERAT	Q A R K U B E R A T
1	26	KUÇOVË	
6	20	URA VAJGURORE	
4	14	SKRAPAR	
2	6	POLIÇAN	



BASHKIA

TOTAL

4230

ANKESA

TË ZGJIDHURA

2063

ANKESA

QARKU ELBASAN

● ELBASAN

163

70

● GRAMSH

76

34

● BELSH

17

8

● LIBRAZHD

32

16

● PËRRENJAS

50

16

QARKU DURRËS

● CËRRIK

20

5

● PEQIN

9

1

● DURRËS

174

40

● KRUJË

26

7

● SHIJAK

17

1



TË ZGJIDHURA	TOTAL	B A S H K I A	
2063	4230		
ANKESA	ANKESA		
117	181	FIER	●
84	115	LUSHNJË	●
17	33	DIVJAKË	●
21	31	PATOS	●
19	27	ROSKOVEC	●
2	17	MALLAKASTËR	●
8	101	MIRDITË	●
3	80	LEZHË	●
5	56	KURBIN	●

Q A R K U
FIER

Q A R K U
LEZHË



BASHKIA

TOTAL

4230

ANKESA

TË ZGJIDHURA

2063

ANKESA

QARKU
KUKËS

● KUKËS

56

1

● TROPOJË

14

1

● HAS

9

0

● SHKODËR

102

28

QARKU
SHKODËR

● MALËSI E MADHE

15

5

● FUSHË ARRËZ

9

3

● PUKË

7

4

● VAU DEJËS

5

1



TË ZGJIDHURA	TOTAL	B A S H K I A	
2063	4230		
ANKESA	ANKESA		
23	65	GJIROKASTËR	●
7	27	MEMALIAJ	●
6	17	TEPELENË	●
9	16	KËLCYRË	●
6	9	PËRMET	●
4	7	DROPULL	●
5	5	LIBOHOVË	●
29	70	DIBËR	●
9	54	MAT	●
14	32	KLOS	●
5	19	BULQIZË	●

Q A R K U
GJIROKASTËR

Q A R K U
DIBËR

NOTA IME

Për çdo institucion, zyrë, sportel, qytetarët mund të vendosin notën (nga 1-10) pas marrjes së një shërbimi.

Nga dhjetori 2018 ka nisur procesi i zbatimit të një rrjeti të gjerë teknologjik, që do të instalohet në çdo institucion ofrues shërbimesh, i cili do të ndërveprojë automatikisht me platformën e bashkëqeverisjes për të gjeneruar në kohë reale, nivelin e pëlqyeshmërisë për shërbimin e kërkuar.

Më poshtë notat e qytetarëve për nivelin e pëlqyeshmërisë së shërbimit janar-dhjetor 2018.

INSTITUCIONI

NUMRI I VLERESIMEVE

164

TOTAL

NOTA MESATARE

6.6

ANKESA

● KRYEMINISTRIA	21	6.5
● MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTEVE DHE RINISË	15	6.4
● MINISTRIA E BRENDSHME	10	6.1
● MINISTRIA E BUJQESISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	7	6.1
● MINISTRIA E DREJTËSISË	45	2.6
● MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME	3	10.0
● MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN	1	10.0
● MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË	15	6.3
● MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	20	5.6
● MINISTRIA E MBROJTJES	3	9.7
● MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTES SOCIALE	21	7.0
● MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	3	3.3



UNIVERSITETI IM

DRITARJA PËR TË KONTRIBUAR NË PAKTIN PËR UNIVERSITETIN

Platforma e bashkëqeverisjes, shërbeu si një dritare ndërlidhëse me çdo student e pedagog për të përcjellë sugjerime konkrete mbi qëndrimin e qeverisë dhe draftin paraprak për Universitetin ku u shpalosën në mënyrë transparente 8 pikat dhe përtej, ndaj kërkesave të studentëve. Përmes kësaj hapësire nga data 19 dhjetor studentë e pedagogë nëpërmjet përfshirjes aktive përmes komenteve të tyre publike dhe private dhanë kontributin konkret dhe shtuan zërin e tyre për Paktin për Universitetin. Të gjithë komentet e ardhura në platformën e bashkëqeverisjes iu përcollën dhe integruan në materialin e grupit të punës të ngritur për këtë qëllim.

KOMENTE

KOMENTE PUBLIKE

57

TOTAL

KOMENTE TË FSHEHURA

44

TOTAL

● KOMENT I PËRGJITHSHËM

28

23

● PËR UNIVERSITETE NË VEÇANTI

16

14

● SHTO PIKËN TËNDE

13

7

101

INTERPELANCA IME

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 14 interpelanca

1 INTERPELANCË ME NAFTËTARËT E BALLSHIT, 22 JANAR 2018

Interpelancë me Kryeministrin e Shqipërisë, Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri dhe Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj.

2 INTERPELANCË PËR ECURINË E DIALOGUT ME GREQINË, 5 SHKURT 2018

Interpelancë e kërkuar nga një grup studentësh të ekselencës vendas dhe të huaj me Ministrin për Evropën dhe punët e Jashtme, Ditmir Bushati.

3 INTERPELANCA ME ISH TË DËNUARIT POLITIKË, QË KANË PUNUAR NË MINIERA, 28 MARS 2018

Interpelancë e kërkuar nga një grup përfaqësuesish ish të dënuar politikë me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj lidhur me njohjen e kohës së vuajtjes së dënimit të tyre, si kohë pune në minierë në nëntokë.

4 INTERPELANCË MBI TARIFËN PËR MIRËMBAJTJEN E RRUGËS SË KOMBIT, 5 PRILL 2018

Interpelancë e kërkuar nga një përfaqësi e banorëve të qytetit të Kukësit, me Kryeministrin dhe Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri.

5 INTERPELANCË PËR STATUSIN E MINATORIT, 16 PRILL 2018

Interpelancë e kërkuar nga përfaqësues të sindikatës së minatorëve me Kryeministrin, Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri dhe Ministrin e Financës dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj.

6 INTERPELANCË ME PËRFAQËSUES TË BIZNESIT TË VOGËL, 4 MAJ 2018

Një përfaqësi e biznesit të vogël i cili përfshihej për herë të parë në skemën e TVSH me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj lidhur me efektet e këtij ndryshimi në ecurinë e biznesit dhe çmimeve të produkteve



7 INTERPELANCË PËR PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN, 11 QERSHOR 2018

Interpelancë e kërkuar nga një grup studentësh të ekselencës me Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati në prag të samitit për çeljen e negociatave të BE me Shqipërinë.

8 INTERPELANCË ME NJË GRUP INTERESI PËR SIGURINË USHQIMORE, 9 KORRIK 2018

Interpelancë e një grupi interesi nga sektori ushqimor me Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peleshi. Masat e marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë sezonit për sigurinë ushqimore. Aksioni për sigurinë e mishit dhe qumështit që përdoren nga konsumatorët.

9 INTERPELANCË PËR RIVLERËSIMIN E DIPLOMAVE PËR INFERMIERËT E PËRGJITHSHËM, 20 SHATATOR 2018

Një përfaqësi e infermierëve të përgjithshëm, thirrën në interpelancë Ministren e Arsimit Sportit dhe Rinisë Lindita Nikolla, për të diskutuar kërkesën e tyre për rivlerësimin e diplomave me afat 3.5 vite në nivel master. Kjo interpelancë plotësoi kërkesën e tyre dhe të gjitha diplomat në degën "Infermieri e Përgjithshme" nga vitet akademike 2000 – 2008, u vlerësuan nga niveli Bachelor në nivelin Master Shkencor duke ndikuar direkt me rritjen e nivelit të pagës dhe avancimit në karrierë.

10 LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE TË NISJES DHE MBËRRITJES TË ANIJEVE TË PESHKIMIT, 2 SHTATOR 2018

Konfederata e Prodhuesve Shqiptarë të Peshkimit dhe Akuakulturës kërkuar në interpelancë përfaqësues nga Ministria e Brendshme për lehtësimin e procedurave të nisjes dhe mbërritjes së anijeve të peshkimit në porte dhe zbatimin e kontrolleve me bazë analizën e riskut.

11 PARANDALIMI I TREGTIMIT TË BARNAVE PA RECETË, 4 TETOR 2018

Me kërkesë të një grupi qytetarësh dhe farmacistësh u zhvillua interpelancë me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manasterliu, mbi masat e ndërmarra për parandalimin e tregtimit të barnave pa receta dhe sigurinë e tyre në tregun farmaceutik. Në vijim, MSHMS ngriti një Task – Forcë për kontrollet në njësitë farmaceutike për barnat pa receta, pa pullën e sigurisë apo që mbahen në kushte të papërshtatshme në një aksion mbarëkombëtar.



12 INTERPELANCË ME NJË GRUP INTERSI NGA SEKTORI BANKAR, I NOTERËVE DHE NDËRTUESVE, 17 TETOR 2018

Interpelancë me Ministrin e Drejtësisë Etilda Gjonaj, për shërbimet e orfuara nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. "Fast Track", ose shërbimi i shpejtë për 24 orë, mundëson që qytetarët dhe bizneset të përfitojnë brenda ditës një listë me 9 shërbimet, më të kërkuara dhe që zënë rreth 40% të volumit të punës në hipotekën e Tiranës.

13 SHËRBIME KONSULLORE ONLINE, 8 NËNTOR 2018

Problematikat e hasura, shërbimet e reja të ofruara online, lehtësimi i procedurave për qytetarët, me përfaqësues shqiptarë nga Konsullata e Përgjithshme në Milano dhe Ambasada Shqiptare në Athinë me Ministrin Ditmir Bushati.

14 INTERPELANCË PËR REHABILITIMIN E MINIERAVE TË BRAKTISURA PARA VITEVE 1990, 11 NËNTOR 2018

Interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë Damian Gjiknuri, kërkuar nga një grup banorësh dhe minatorësh të zonave Librazhd, Përrenjas, Pogradec lidhur me rehabilitimin e minierave të zonës.



IDETË PËR NISMA KOMUNITARE, PROJEKTE KONKRETE ME INTERES PUBLIK TË REALIZUARA NË VITIN 2018.

1 TRE LËNDË NË GJASHTË ORË

Një grup prindërisht dhe mësuesish rekomanduan nismën për reduktimin e lëndëve mësimore të zhvilluara në ditë për të lehtësuar procesin e nxënies si dhe peshën e çantave të nxënësit. Kjo nismë u jetësua me reduktimin e 3 lëndëve në 6 orë mësimi.

2 NDALIMI I AKTIVITETIT TË GUROREVE PRANË ZONAVE URBANE

Një grupim qytetarësh të Urës Vajguore, propozuan marrjen e masave për ndalimin e aktivitetit të gurore pranë zonave urbane.

3 REDUKTIMI I PËRDORIMIT TË QESEVE PLASTIKE

Një grup ambientalistësh dhe biznesesh i propozuan Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit një nismë e cila parashikonte ndryshime ligjore për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike si dhe nxitjen e përdorimit të materialeve të riciklueshme nismë kjo e cila u reflektua në ndryshime ligjore dhe ka filluar zbatimin.

4 SIGURIA RRUGORE NË RRETHIN E KURBINIT

Një grup qytetarësh në qytetin e Laçit kërkuan marrjen e masave për ndërhyrjen në sistemin rrugor për shmangien e aksidenteve dhe përmirësimin e sinjalistikës rrugore. Përfaqësues të ARRSH prezantuan projektet e reja të cilat përfshijnë edhe zonën e Kurbinut.

5 PËRMIRËSIM I OFRIMIT TË SHËRBIMIT MJEKSOR DHE FARMACEUTIK NË RUBIK

Nisma e qytetarit Ndue Përlala, në platformën e bashkëqeverisjes, bëri të mundur që qytetarët e Rubikut të marrin shërbime shëndetësore dhe farmaceutike duke rregulluar oraret e shërbimit edhe pasditeve për qendrat shëndetësore si dhe ofrimin e shërbimeve farmaceutike dhe në ditët e pushimit. Kjo nismë i vjen në ndihmë të gjithë komunitetit të banorëve të Rubikut dhe zonës përreth.

6 RUAJTJA E PYJEVE NË SHESHE TË BULQIZËS

Një grupim qytetarësh paraqitën në rubrikën "Nisma Ime" të platformës së bashkëqeverisjes, shqetësimin e tyre për shfrytëzimin e pyjeve në Sheshe të Bulqizës. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi zhvilloi më 21 korrik, një takim të hapur me këtë komunitet ku informoi për nisjen e kontrollit nga ana e strukturave të ministrisë si dhe garantoj angazhimin e ministrisë për të qenë në krah të qytetarëve në mbrojtje të mjedisit.



FUSHA E INTERESIT

APLIKANTË

416

TOTAL

● ARSIMI	47
● BUJQËSIA	24
● DREJTËSIA	42
● EKONOMIA	28
● ENERGJIA	24
● FINANCA	32
● INFRASTRUKTURA	17
● INTEGRIMI EUROPIAN	13
● KULTURA	6
● MBROJTJA SOCIALE	18



APLIKANTË

416

TOTAL

FUSHA E INTERESIT

17	MJEDISI
54	PUNA
16	PUNËT E BRENDSHME
16	PUNËT E JASHTME
5	RINIA
4	SIPËRMARRJA
4	SPORTI
30	SHËNDETËSIA
12	TURIZMI
7	ZHVILLIMI RURAL



BASHKËQEVERISJA ME QYTETARËT, TAKIMET NË RRETJE

Për forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e platformës së bashkëqeverisjes janë zhvilluar takime të dedikuara me qytetarët.

Gjatë 1 viti platforma e bashkëqeverisjes u prezantua në qytetet e Rrëshenit, Burrit, Hasit, Lushnjës, Laçit, Elbasanit, Tiranës, Beratit dhe në turin e llogaridhënies në qytetin e Cërrikut, Korçës, Himarës, Durrësit etj. Këto takime kanë shërbyer për të dhënë më shumë informacion rreth funksionimit të platformës, por edhe njohjen e drejtpërdrejtë me problematikat e qytetarëve, orientimin e tyre për përdorimin e platformës si dhe trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave brenda 10 ditëve punë.

Histori **SUKSESI**

18.276 raste të zgjidhura për periudhën janar-dhjetor 2018, nga të cilat 759 raste të spikatura suksesi përbëjnë rekordin pozitiv të platformës së bashkëqeverisjes shqiperiaqeduam.al. Qytetarë që prej vitesh kërkonin të drejtën e tyre, iu bashkuan platformës së bashkëqeverisjes duke kontribuar si në përmirësimin e shërbimeve ashtu edhe ndëshkimin e zyrtatëve përgjegjës për vonesat e shkaktuara në misionin e përbashkët për bashkëqeverisjen e Shqipërisë që Duam.



EDI KOLA

Qytetarja Edi Kola, nga Tirana, kërkonte të pajisej me certifikatë pronësie pranë ZVRPP Tiranë dhe kishte që nga viti 2009 që nuk po merrte zgjidhje për këtë çështje. Më 12 korrik iu drejtua platformës së bashkëqeverisjes dhe më 16 korrik u pajis me certifikatën e pronësisë për banesën e saj familjes së saj.



SILVANA ISMAILI

Silvana Ismaili, nga Tirana, me profesion infermiere adresoi shqetësimin e saj mbi shitjen e medikamenteve psikotrope nga dy farmaci në Tiranë, pa rekomandim dhe recetë nga mjeku. Përveç penalizimit të dy farmacive të denoncuar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ngriti menjëherë një task-force për kontrollin e menjëhershëm në të gjithë territorin për të parandalimin e këtij fenomeni dhe marrjen e masave të menjëhershme në rastet e shkeljeve. Nga task-force për periudhën tetor-dhjetor 2018 janë penalizuar 278 subjekte farmaceutike.



MAJK ILIA

Majk Ilia kishte përfunduar studimet në Universitetin Politeknik "Aristoteli" të Selanikut dhe prej dy vitesh përpiquej të njehësonte diplomën e tij e cila fillimisht iu njehësua si Bachelor, ndonëse ishte një diplomë 5-vjeçare e integruar. Kjo problematikë u ngrit gjatë turit të llogaridhënies në Korçë, u adresua në platformë dhe gjeti zgjidhje për 10 ditë.



ANDON PRIFTI

Gjatë turit të llogaridhënies në Himarë më 22.06.2018, z. Andon Prifti, u ankua se edhe pse me arsimin përkatës, nusja e djalit të tij, e ve dhe me dy fëmijë ishte e pa punë. Ankesa u hodh në platformën e bashkëqeverisjes dhe me ndërmjetësimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit znj. Arta Prifti u punësua si edukatore në një institucion privat.



DENIS HOXHOLLI

Denis Hoxholli, nga Prrenjasi, tetraplegjik dhe i sapodiplomuar iu drejtua me një kërkesë punësimi platformës së bashkëqeverisjes. SHKP shqyrtoi mundësinë e punësimit për Denisin, të diplomuar në Degën Financë Kontabilitet, PAK tetraplegjik i grupit të dytë dhe më 28 mars 2018 në bashkëpunim me Bashkinë Përrenjas qytetari u punësua në këtë institucion si specialist në sektorin e ndihmës sociale.



GËZIM TOPUZI

Kërkesën për pajisje me karrocë për xhaxhain e tij Gëzim Topuzi, invalid pune e drejtoi në platformë nipi i tij nga Peshkopia. Shërbimi Social Shtetëror dërgoi menjëherë specialistët në banesën e z. Topuzi dhe brenda 5 ditësh u pajis me karrocë.



SHEFKI HAKA

Shefki Haka, ish minator, ankohej se për 4 vjet nuk ka gjetur zgjidhje lidhur me konfirmimin e pagave për punën e kryer në minierën e gymyrgurit Krrabë, për rrjedhojë pensioni i ishte caktuar pension minimal. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i kërkoi Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, të verifikonte me bordero vërtetimin e pagës duke rishqyrtuar pensionin e tij dhe duke i caktuar pensionin e plotë konform ligjit.



UKI MAZRREKU

Prej 13 vitesh z. Mazrreku kishte bërë vetdeklarimin për legalizimin e banesës të ndodhur në Babrru pa mundur të gjejë zgjidhje duke u paraqitur sistematikisht në sportel. Më 20 dhjetor qytetari iu drejtua platformës dhe më 28 dhjetor u njoftua se leja e legalizimit ishte emetuar dhe dërguar për regjistrim në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.



SHËRBIMI ZJARRFIKËS KURBIN

Punonjësit e shërbimit zjarrfikës në qytetin e Kurbin, iu drejtuan platformës së bashkëqeverisjes për zgjidhjen e një ngërçi institucional, lidhur me sistemin e gradimit për këta punojës. Me zgjidhjen e kësaj problematike, 118 punonjës të shërbimit zjarrfikës, të nivelit të mesëm dhe të lartë në të gjitha qarqet e Shqipërisë, përfituan të drejtën e marrjes së gradave dhe shpërblimin financiar përkatës.





MASAT NDËSHKIMORE

Për zyrtarët e identifikuar nga hetimi administrativ si përgjegjës për mospërgjigjen dhe mosndjekjen e rasteve në kohë ndaj qytetarëve.



INSTITUCIONI	NUMRI I MASAVE	LARGIME NGA DETYRA
	649	237
● MINISTRIA E DREJTËSISË	330	152
● MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	81	23
● MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE	73	6
● MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË	70	2
● MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË	46	21
● MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	29	26
● MINISTRIA E BRENDSHME	9	1
● MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	8	5
● MINISTRIA E MBROJTJES	3	1



AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE



PLAY STORE



APP STORE

www.shqiperiaqeduam.al